



Datë: 02.06.2025  
Numër Protokolli: 3750/2025

A.nr.587/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.587/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.S., kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen administrative-juridike “*kontestim konkursi*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

***Përfundon procedimi administrativ*** i filluar sipas ankesës A.nr.587/2025 të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.S.

### A r s y e t i m

Ankuesi, B.S.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 03.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2206/2025 e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.587/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 11.03.2025, lidhur me shpalljen e rezultatit përfundimtar për pozitën e punës “ Udhëheqës i Sektorit për Inspektime”, Divizioni i Inspektimit Fitosanitar (kufitar) në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, ***sepse:***

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 08.01.2025, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016253, për pozitën “*Udhëheqës i*

*Sektorit të Inspektiveve*''- Drejtues i Ulët, me afat aplikimi nga data 09.01.2025 deri me datë 07.02.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa i njëjti i është nënshtruar edhe fazës së testimit me shkrim dhe se sipas renditjes përfundimtarë të kandidatëve, ankuesi rezulton se ka arritur zero (0) pikë nga vlerësimi i testit me shkrim.

Tutje, Sektori i Personelit i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 11.03.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidati I.M, me gjithsejtë 96 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidat fitues për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Inspektiveve*.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.588/2025 të datës 26.05.2025, me të cilin vendim është anuluar Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve e datës, 10.03.2025, e Sektorit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues, në procedurën e pranimit me numër reference RN00016253, dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, procedura e pranimit është kthyer në fazën e verifikimit paraprak.

Andaj, duke qenë se me Vendimin .nr.588/2025 të datës 26.05.2025, është anuluar faza e vlerësimit profesional të kandidateve dhe meqenëse ky ishte edhe pretendimi ankimor i ankuesit, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.587/2025, të datës 03.04.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.587/2025**

**Atdhe GASHI**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit B.S.;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.